



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SARANDË
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE E KONTROLLIT
TË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

Sarandë më 31.01.2025

Nr 606 prot.

Lënda: Kthim përgjigjeje.

Qendra "Res Publica"

Blv. "Gjergj Fishta", Nd.24, H.3, Ap.7, Tiranë

Në përgjigje të shkresës tuaj me Nr. 184/24 nëpërmjet email zyrtar të Bashkisë Sarandë, kërkesë për të dhëna për lejet e ndërtimit për periudhën 2022-2024, si dhe në mbështetje të ligjit nr.119, datë 18.09.2014 "Për të drejtën e informimit", nga verifikimet e kryera pranë Drejtorisë të Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit rezultojnë:

Mbështetur në pikën 10 të VKM-së, nr. 430, datë 11.7.2018, "Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore për sistemin elektronik të lejeve (e-leje)", përcaktohet se:

"Të gjitha aplikimet për leje në Republikën e Shqipërisë, sipas ligjit nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", të ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij kryhen nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve, në portalin e-Albania."

Më tej, lidhur me mundësinë e institucionit tonë për të bërë të mundur identifikimin dhe përmbledhjen e të gjithë praktikave të mundshme të vendimmarrjes për leje ndërtimi për periudhën 2022-2024, në një kohë sa më të shkurtër, dëshirojmë të sjellim në vëmendjen tuaj se për arsye teknike sistemi elektronik i e-Leje (si regjistri zyrtar i depozitimit të vendimeve të Kryetarit për leje), në si organe të vetqeverisjes vendore, na mundëson kërkimin në platformë vetem nëpërmjet fushave/ rubrikave, si më poshtë vijon:

- Nr. protokolli/regjistri;
- Nr. aplikimi;
- Datë aplikimi;
- Emër dhe mbiemër aplikanti;
- Emër dhe mbiemër i specialistit/ nëpunësi që ka shqyrtuar aplikimin.

Ky sistem nuk na mundëson teknikisht hartimin apo gjenerimin e raporteve përmbledhëse tabelare ose sasiore në mënyrë që të mund të bëjmë evidentimin e listës së lejeve. Në vijim, ju sjellim në vëmendje, se në mbështetje të VKM-së nr. 430, datë 11.7.2018, "Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore për sistemin elektronik të lejeve (e-leje)", sipas pikës 8, pikës 2 dhe pikës 3, germa d, përcakton se është AZHT, që:

- Sipas pikës 2: *"...ka akses në sistemin elektronik të lejeve (e-Leje), në drejtim të verifikimit të të dhënave parësore dhe dytësore që kjo bazë të dhënash grumbullon..."*
- Sipas pikës 3, germa d: *"Shërben, në bashkëpunim me AKSHI-n, si burim informacioni dhe suportit (Help Desk) për shërbimet që ofrohen nëpërmjet sistemit."*

Ndaj në vijim ju sugjerojmë t'i drejtoheni AZHT/ AKSHI në mënyrë që të keni një përgjigje ezauruese/ përfundimtare në lidhje me lejet e miratuar për përiudhën që ju kërkon.

Për më shumë, mund të shprehemi se, për periudhën prej muajit korrik të vitit 2023 e deri në dhjetor të vitit 2024, drejtoria e planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të territorit ka mbajtur korespondencë nëpërmjet email zyrtar me zyrën rajonale Vlorë të INSTAT ku bëhen raportimet në bazë të 3-mujorëve për veprimtarinë ndërtimore të pajisur me leje sipas legjislacionit sektorial në fuqi. Për periudhën e sipërcituar janë raportuar 6 (gjashtë) herë, nga ku rezulton se, mbështetur në nenin 29 dhe nenin 39, të ligjit nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, janë dhënë 177 vendime miratimi të lejeve, të cilat referuar nenit 11 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, dhe në platformën e-Albania në shërbimin përkatës e-Leje, i përkasin kategorive si vijon: i) Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m², ii) Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe deri në 250 m², iii) Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe më të madhe se 250 m², iv) Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe deri në 250 m², v) Leje ndërtimi për rikonstrukcion me ndryshim funksioni, vi) Leje ndërtimi për rikonstrukcion pa ndryshim funksioni, etj.; dhe janë dhënë 97 vendime miratimi të lejeve, të cilat referuar nenit 7 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, klasifikohen në punime që kryhen me deklaratë paraprake punimesh nëpërmjet sistemit elektronik e-leje.

Në rast se ju nevojitet një informacion më i detajuar mund ti referoheni publikimeve periodike të INSTAT në lidhje me statistikat e gjeneruara në raport me numrin e lejeve, sipërfaqet e ndërtimit, etj.

Ju faleminderit për bashkëpunimin.

KRYETAR

Oltion Çaçi

(me urdhër delegimi)

Zv/KRYETAR

Irena Marjani

